Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

Në mbështetje të neneve 12, 14.2, 17 të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale; të neneve 3 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4, neni 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, neni 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 dhe neni 11 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës; nenit 23, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 të Rregullores (QRK) nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës; si dhe nenit 33.2, pika (a) të Statutit të Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 11.9.2026 miratoi këtë

V E N D I M

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË PRISHTINËS - LOKACIONI "TULLËTORJA"

I

Jepet në shfrytëzim afatgjatë prona e paluajtshme komunale në lokacionin "Tullëtorja", investitorit BGC SHPK, me NUI 810045981, me pronar Agim Gërbeshi, sipas kushteve të këtij vendimi, ofertës së negociuar dhe kontratës që do të lidhet pas hyrjes së vendimit në fuqi.

II

Prona identifikohet si vijon: Zona kadastrale Prishtinë; parcela nr. 10935-0, sipërfaqja 45,329m² e destinuar si tokë ndërtimore, me pronar të regjistruar Komuna e Prishtinës. Certifikata e pronës dhe kopja e planit janë pjesë përbërëse e dosjes.

III

Prona jepet në shfrytëzim për realizimin e projektit "ART-TECH TULLËTORJA" sipas planit ideor, planit investiv, planit dinamik dhe kushteve urbanistike, ndërtimore, mjedisore dhe teknike të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

IV

Afati i dhënies në shfrytëzim është 50 vjet, duke filluar nga data e hyrjes së vendimit në fuqi. Pas përfundimit të afatit, prona i kthehet titullarit.

V

Dhënia në shfrytëzim bëhet me kompensim në vlerën dhe mënyrën e përcaktuar në ofertën e negociuar.

VI

Autorizohet Kryetari i Komunës që, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe përfundimit të shqyrtimit të ligjshmërisë, të nënshkruajë kontratën me investitorin, në përputhje me këtë vendim dhe dokumentacionin e negociuar.

VII

Për zbatimin dhe mbikëqyrjen e vendimit përgjegjëse janë Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Pronës, Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Investimeve Kapitale, Drejtoria e Financave, Drejtoria e Inspeksionit, dhe njësitë e tjera sipas kompetencës.

VIII

Ky Vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-463/01-141071/26, më 14.9.2026

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina